

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA - V.LADA - GOVERNMENT  
MINISTRIA E EKONOMISE DHE AMBIENTIT  
MINISTRETVO EKONOMY, E I ZIVOTNE SREDINE  
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

Njësia Org.  
Org. Jedis  
Org Unit

Nr. i faqes  
E foli stranic  
No. pages

01/3

Nr. Prot.  
Pr. Prot.

798

Data:  
Datum:

25.03.21

PRISHTINE A

NO.1

**KMDK. SH.A**

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A  
KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C  
KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD

Nr. 01-52/1

Dt. 25/03/2021

Prishtinë

Shtojcë
3



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A  
Kosova Landfill Management Company J.S.C  
Rr.Bekim Fehmiu 137,Lakrishte,10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552  
www.kmdk-ks.org

**KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A**

**RREGULLORE NR. 25/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES  
NR. 23/2020 PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT, STRUKTURËN ORGANIZATIVE,  
KATEGORIZIMIN DHE PËRSHKRIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

Në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 130 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 7 të Statutit të Kompanisë, në bazë të Ligjit 03/L-212 të Punës në Kosovë, në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrje Publike, në bazë të Rregullores Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Venëve të Punës në KMDK SH.A, Bordi i Drejtorëve të KMDK SH.A në mbledhjen e mbajtur me datë 16.03.2021, miraton;

**RREGULLOREN NR 25/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E  
RREGULLORES NR. 23/2020 PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT, STRUKTURËN  
ORGANIZATIVE, KATEGORIZIMIN DHE PËRSHKRIMIN E VENËVE TË PUNËS**

**Neni 1**

**Ndryshimi ka të bëjë:** Pozita zyrtar për përkthime në Gjuhën Angleze, zëvendësohet me pozitën zyrtar për mbrojtjen e mjedisit:

1. Të neni 6 i Rregullores Nr.23/2020, paragrafi 4, pika 4.3.7, pozita zyrtar për përkthime në Gjuhën Angleze, zëvendësohet me pozitën zyrtar për mbrojtjen e mjedisit;
2. Pozita e zyrtarit për mbrojtjen e mjedisit sistemohet në Drejtorinë Operative, përkatësisht në Njësinë për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 13, paragrafi 7 i Rregullores Nr.23/2020.

**Neni 2**

**Përshkrimi i detyrave të punës:**

**POZITA: ZYRTAR PER MBROJTJEN E MJEDISIT**

<b>Titulli i pozitës;</b>	<b>Zyrtar për Mbrojtjen e Mjedisit</b>
<b>Raporton tek;</b>	<b>Udhëheqësi i Njësisë për Mbrojtjen e Mjedisit</b>
<b>Detyrat dhe Përgjegjësitë;</b>	<p>-Në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe stafin e deponisë harton planet për menaxhimin e brezit të gjelbër, bënë mbikëqyrjen, përcjell mbarëvajtjen dhe realizimin e detyrave të stafit të punëtorëve në hortikulturë në të gjitha deponitë sanitare.</p> <p>-Inspekton dhe monitoron efektivitetin e skemës së pranimit dhe deponimit të mbeturinave si dhe menaxhimit të ujërave të zeza në kontekst të mbrojtjes së mjedisit. Në lidhje me këtë harton raporte dhe jep rekomandime për përmirësimin e gjendjes.</p> <p>-Në koordinim me mbikëqyrësin, përcjell gjendjen në deponitë sanitare,</p>

	<p>bënë inspektimin dhe monitorimin e nivelit të ndotjes nga aktivitete në deponi, për këtë harton raporte dhe propozon masat që duhet ndërmarr.</p> <p>-Ndhmon në përgatitjen e planeve afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata për mbrojtjen e mjedisit</p> <p>-Grumbullon, sistemon, përpunon shënimet dhe përgjigjet në procesverbalet e Inspektoriatit të mjedisit.</p> <p>-Bënë inspektimin dhe monitorimin e aktiviteteve që shkaktojnë çrregullime apo ndikime negative në mjedis dhe propozon masa për eliminimin e tyre.</p> <p>-Përgatitë raporte, harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin, stafin dhe menaxherët e deponive për zbatimin e objektivave, planeve të njësisë dhe jep sugjerime për realizimin e tyre.</p> <p>-Kryen edhe detyra tjera profesionale të cilat i kërkohen nga Mbikëqyrësi dhe Drejtori i Operativës (DO).</p>
<b>Kualifikimet dhe përvoja e punës;</b>	<p>-Diplomë Universitare në fushën e mjedisit, Inxhinier Mjedisit, Ekologjisë, Teknolog;</p> <p>-Të ketë së paku një vit përvojë pune;</p>
<b>Aftësitë kryesore;</b>	<p>-Kapacitet për punë ekipore;</p> <p>-Aftësi të mira komunikimi;</p> <p>-Aftësi të shkëlqyeshme në përdorim të kompjuterit, Microsoft Office, Power Point dhe Internet;</p> <p>-Njohuri mbi legjislacionin mjedisor në Kosovë dhe standardet e BE-së;</p> <p>-E preferueshme njohja e gjuhës angleze në të folur dhe shkruar.</p>
<b>Paga Mujore</b>	<b>Niveli VI</b>

### Neni 3

1. Në kuadër të kësaj Rregulloreje përfshihet edhe Aneksi 2, Lista e pozitave, niveli i pagave dhe paga sipas hierarkisë.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të saj nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

Prishtinë, Mars 2021

Mentor Hoxhaj



Kryesues i BD të KMDK SH.A



**ANEKSI 2**

**LISTA E POZITAVE, NIVELI I PAGAVE DHE PAGA SIPAS HIERARKISË**

<b>POZITA: ZYRTAR PER MBROJTJEN E MJEDISIT</b>				
<b>Grupi i Pozitive</b>	<b>Titulli i Pozitës</b>	<b>Niveli i Pagës</b>	<b>Paga në Euro</b>	<b>Drejtoria/Departamenti</b>
	<b>Zyrtar për mbrojtjen e mjedisit</b>	<b>VI</b>	<b>642.76</b>	<b>Drejtoria e Operatives - Njësia për Mbrojtjen e Mjedisit</b>





Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A  
Kosovo Landfill Management Company J.S.C  
Rr. Bektim Fehinju 137, I. akrishtë, 10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552  
www.kmdk-ks.org

<b>KMDK. SH.A</b>	
<small>KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD</small>	
Nr. <u>01-31/6</u>	Shtojcë
Dt. <u>19/03/2021</u>	Prishtinë

## Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH.A)

Nr. 06/2021  
Datë 16/03/2021

Në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Kosovës, të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative në Ndërmarrjet Publike, Statutit të KMDK-së, Rregullores Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 16.03.2021 nxjerr:

### V E N D I M

**(Për plotësim-ndryshim të Rregullores Nr.23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës)**

**Ndryshimi ka të bëjë: Pozita zyrtar për përkthime në Gjuhën Angleze, zëvendësohet me pozitën zyrtar për mbrojtje të mjedisit:**

- 1. Të neni 6 i Rregullores Nr.23/2020, paragrafi 4, pika 4.3.7, pozita zyrtar për përkthime në Gjuhën Angleze, zëvendësohet me pozitën zyrtar për mbrojtje të mjedisit;**
- 2. Pozita e zyrtarit për mbrojtje të mjedisit sistemohet në Drejtorinë Operative, përkatësisht në Njësinë për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 13, paragrafi 7 i Rregullores Nr.23/2020.**

**Vendimi i dërgohet:**

1. Arkivit të KMDK-së
2. Anëtarëve të Bordit;
3. NJMNP/MEA

Mentor Hoxhaj  
Kryesues i BD të KMDK SH.A